

Analizë për miratimin dhe
zbatimin e përpjekjeve të partive
politike për

përfaqësim më të madh politik të grave



British Embassy
Skopje



UK International
Development
Partnership | Progress | Prosperity



WFD

Analizë për miratimin
dhe zbatimin e përpjekjeve
të partive politike për
**përfaqësim më të madh
politik të grave**

Projekti:
Praktiko demokraci

Botuesi:
Fondacioni për demokraci të Uestminsterit,
Maqedonia e Veriut
www.wfd.org

Për botuesin:
Dona Kosturanova,
drejtore në vend për zyrën e
Fondacionit për demokraci të Uestminsterit

Autore e analizës:
Bojana Jovanovska

Redaktorë:
Ina Xhugumanova

Redaktimi grafik:
Igor Delov

Përktheu:
Vjosa Taipi

Vendi i lëshimit:
Shkup

Viti i lëshimit:
2024

Kjo analizë u përgatit në kuadër të projektit “Praktiko demokraci” i financuar nga Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar, me mbështetjen e Ambasadës Britanike në Shkup. Mendimet dhe qëndrimet e shprehura në këtë përmbajtje nuk pasqyrojnë gjithmonë mendimet dhe qëndrimet të Qeverisë Britanike.

Përmbajtja

- 7 Parathënie
- 9 Hyrje
- 12 Metodologjia
- 13 Pjesëmarrja politike e grave në Maqedoninë e Veriut
- 17 Angazhimet për barazi gjinore përkundrejt pamjes reale
- 17 Parimi i barazisë gjinore në politikat dhe programet partiake
- 18 Barazia gjinore në partitë politike
- 20 Pjesëmarrja në Kuvend
- 21 Pushteti ekzekutiv dhe lokal
- 23 Avancimi i legjislacionit
- 23 Dukshmëria e politikaneve femra
- 26 Përfundime dhe rekomandime
- 31 Shtojca
- 31 Shtojca 1: Pyetësor për përfaqësuesit/et e partive politike
- 33 Shtojca 2: BRIF NGA KONFERENCA: Strategjitë e partive politike në Maqedoninë e Veriut për pjesëmarrje më të madhe të grave në politikë - 2024

Parathënie

Me këtë analizë, përiqemi të sigurojmë një përmbledhje të situatës – si është pjesëmarrja e grave në partitë politike në periudhën e zgjedhjeve të vitit 2024 dhe çfarë hapash janë ndërmarrë nga partitë për të mundësuar pjesëmarrjen politike dhe çrënjosjen e dhunës ndaj grave në politikë.

Në sferën politike, ka një disproporcion të madh. Megjithëse gratë përbëjnë pak më shumë se gjysmën e popullsisë së përgjithshme në vend, përfaqësimi në pozicione të zgjedhura dhe të emëruara është shumë prapa kësaj përqindjeje.

Maqedonia e Veriut ka bërë përparim me krijimin e kuotave si një sistem mbrojtjeje dhe përfaqësimi mundësues. Pas zgjedhjeve të vitit 2024, kemi 33% deputete femra të zgjedhura në Kuvend, përqindje që rritet menjëherë pas formimit të Qeverisë në 37.5%. Në momentin që heqim kuotat si detyrim ligjor dhe u takon vetë partive politike të propozojnë kandidatë, pjesëmarrja e grave bie në mënyrë dramatike. Një hap përpara në këtë kuptim është vetëm zgjedhja e presidentes së parë femër në vitin 2024. Por pa kuota, në zgjedhjet lokale të vitit 2021 nga 299 kandidatë për kryetarë komunash, vetëm 8% ishin gra, nga të cilat në fund vetëm 2 nga 79 kryetarë të zgjedhur ishin gra, përkatësisht 2,5%. Pjesëmarrja e grave në përbërjen e qeverive as nuk i afrohet barazisë, ndërsa ndonjëherë është në përqindje një shifrore. Historikisht, nga partitë parlamentare në vend, vetëm 2 gra kanë arritur të jenë në pozicionin presidencial. Rrethana të ngjashme mund të shihen në organet drejtuese, ku në nivel qendror përfaqësimi varion nga 50% (në vetëm disa parti) deri në 20%, ndërsa në nivel lokal nuk ka pothuajse as nuk bëhet fjalë për përfaqësim.

Megjithëse situata dhe konteksti më i gjerë që dekurajon pjesëmarrjen e grave janë komplekse, barrierat brenda partive luajnë

një rol të madh. Disa nga masat që vetë partitë politike mund të marrin janë: politikat e brendshme afirmative, përfaqësimi i barabartë i grave në zgjedhjet dhe organet brenda partisë, si dhe për kandidatët në zgjedhje në vend, politikat e barabarta të vendimmarrjes, mbështetja për gratë candidate, ngritja e kapaciteteve të grave në parti, politikat për të parandaluar dhunën me bazë gjinore dhe qasje të tjera.

Sinqerisht shpresojmë që kjo analizë të ndihmojë partitë politike të identifikojnë ndryshimet që mund të bëjnë, për të mundësuar pjesëmarrje më të barabartë të grave, kryesisht në strukturat e tyre, dhe më tej në proceset politike në vend.

Pa pjesëmarrje të barabartë në politikë, shkelen parimet themelore demokratike të përfaqësimit të barabartë dhe nuk sigurohet demokracia përfaqësuese. Me pjesëmarrje të barabartë, ka shumë përfitime, nga sigurimi i diversitetit të perspektivave, deri te krijimi dhe zbatimi i politikave më të mira. Pjesëmarrja e barabartë nuk është vetëm çështje numrash, por e pjesëmarrjes dhe ndikimit real. Kjo është arsyeja pse nevojitet një mjedis politik ku zërat e grave mirëpritën, dëgjohen dhe adresohen.

Dona Kosturanova,
Drejtoreshë e Vendit për
Fondacionin Westminster për Demokraci

Hyrje

Pjesëmarrja e grave në politikë është thelbësore për të siguruar përfaqësimin e perspektivave dhe përvojave të ndryshme në proceset e vendimmarrjes. Duke artikuluar pikëpamjet dhe prioritetet e tyre specifike, gratë mund të kontribuojnë në politikëbërje më gjithëpërfshirëse dhe efektive. Për më tepër, rritja e përfaqësimit të grave në politikë mund të ndihmojë në adresimin e çështjeve specifike gjinore dhe promovimin e barazisë gjinore në të gjitha sferat e jetës shoqërore. Përveç faktit se pjesëmarrja e grave në politikë është një parim themelor demokratik, përvoja që ato sjellin përmes pikëpamjeve dhe ekspertizës së ndryshme është e një rëndësie të veçantë, duke kontribuar kështu në pasurimin e fushave të politikave të dominuara nga meshkujt, siç janë: mbrojtja, siguria, ekonomia dhe biznesi, duke ofruar perspektiva inovative për parandalimin e konflikteve, ndërtimin e paqes dhe çështjet sociale.¹

Angazhimet ndërkombëtare për pjesëmarrje të barabartë politike të burrave dhe grave, veçanërisht përmes vendosjes së kuotave gjinore, kanë kontribuar ndjeshëm në progres, siç tregohet nga të dhënat se vendet që zbatojnë këto angazhime në praktikë tregojnë nivele më të larta të përfaqësimit të grave si në parlamente ashtu edhe në pushtetet lokale. Megjithatë, të dhënat mbi situatën aktuale globale sugjerojnë se, pavarësisht dyfishimit të përfaqësimit të grave në parlamente që nga viti 1995, burrat ende zënë 75% të vendeve, ndërkaq vlerësohet se me këtë ritëm arritja e barazisë gjinore në legjislaturat kombëtare

1 ODIHR. (2014). *Handbook on Promoting Women's Participation in Political Parties*.

do të ishte e arritshme më së shpejti në vitin 2063.² Përveç kësaj, situata në pushtetin ekzekutiv është shumë më e keqe, ku, pavarësisht ngjashmërive në arsim dhe përvojës politike midis burrave dhe grave, gratë janë presidente të shteteve ose kryetare të qeverive në vetëm 21 vende, ndërsa barazia në këtë nivel nuk pritet në 130 vitet e ardhshme.³

Situata në Maqedoninë e Veriut vetëm konfirmon pamjen globale të situatës së pjesëmarrjes së grave në politikë, ku gratë vazhdojnë të përballen me pengesa për përfaqësim të plotë dhe të barabartë në politikë. Pavarësisht përpjekjeve për të rritur pjesëmarrjen politike të grave, ka ende pengesa të konsiderueshme, duke pasur parasysh se gratë mbeten të nënpërfaqësuara në pozicionet kryesore vendimmarrëse në partitë politike, qeverinë dhe pushtetin lokal.

Partitë politike luajnë një rol të rëndësishëm në formësimin e pjesëmarrjes së grave në politikë, shpesh duke shërbyer si barriera duke dështuar në rekrutimin ose mbështetjen e mjaftueshme të kandidatëve femra dhe duke zbatuar procese të njëanshme të përzgjedhjes. Sidoqoftë, kur mungojnë rastet e vullnetit politik ose gatishmërisë së partive të punojnë për të eliminuar pabarazitë gjinore, masat e zbatuara në mënyrë përkatëse, siç janë kuotat gjinore, mund të ndihmojnë në rritjen e përfaqësimit të grave në politikë.

Qëllimi i kësaj analize është të vlerësojë miratimin dhe zbatimin e angazhimeve për barazi gjinore gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet presidenciale dhe parlamentare, të cilat u ndërmorën nga nëntë parti politike⁴ në Maqedoninë e Veriut në kuadër të konferencës «Dhuna ndaj grave në politikë - zgjidhje për forcimin e pjesëmarrjes politike

2 UN Economic and Social Council. (2020). *Commission on the Status of Women - Sixty-fifth session 15-26 March 2021, Women's full and effective participation and decision-making in public life, as well as the elimination of violence, for achieving gender equality and the empowerment of all women and girls. Gjendet në: <https://undocs.org/Home/Mobile?FinalSymbol=E%2FCN.6%2F2021%2F3&Language=E&Device-Type=Desktop&LangRequested=False>*

3 Ibid.

4 Aleanca për Shqiptarët, Alternativa, Partia VMRO-Demokratike për Unitet Kombëtar Maqedonas - VMRO-DPMNE, Lëvizja Besa, Ripërtëritja Demokratike e Maqedonisë - DOM, Bashkimi Demokratik për Integrim - BDI, Partia Liberal Demokratike - PLD, Partia e Re Social Demokratike - PRSD, Bashkimi Social Demokratik i Maqedonisë - LSDM.

të grave», mbajtur më 9 shkurt 2024 në Shkup. Ngjarja u organizua nga Fondacioni Westminster për Demokraci (WFD), në partneritet me Institutin për Studime të Komunikimit (ISK) dhe me mbështetjen e Ambasadës Britanike. Duke marrë parasysh rolin e tyre për pjesëmarrjen e grave në politikë, partitë politike në fjalimet e tyre në konferencë shprehën angazhimin e tyre për sigurimin e përfaqësimit dhe pjesëmarrjes më të madhe të grave në politikë. Kështu, zotimet, së bashku me gjetjet kryesore të konferencës, si dhe udhëzimet e përgjithshme dhe propozimet që partitë mund të aplikojnë për të përmirësuar pjesëmarrjen e grave në politikë, u bënë publike në formën e një përmbledhjeje të shkurtër menjëherë pas konferencës dhe iu dërguan partive politike gjatë marsit 2024.⁵

Analiza fillon me prezantimin e metodologjisë për kryerjen e hulumtimit, duke aplikuar analiza cilësore të përmbajtjes dhe intervista, dhe vazhdon me një pasqyrë të shkurtër të situatës aktuale në Maqedoninë e Veriut në lidhje me pjesëmarrjen e grave në politikë. Në kuadër të seksionit të titulluar Angazhime për barazi gjinore kundrejt imazhit real, janë paraqitur rezultatet e hulumtimit të kryer, të cilat analizohen paralelisht me angazhimet e veçanta të dhëna nga partitë, të cilat janë përmbledhur sipas temave. Analiza përfundon me pjesën me konkluzione dhe rekomandime, ku përmbledhen gjetjet kryesore në lidhje me përmbushjen e angazhimeve nga partitë, si dhe hapat e mundshëm për forcimin e mëtejshëm të pjesëmarrjes së grave në politikë.

5 Westminster Foundation for Democracy. (2024). *BRIF NGA KONFERENCA: Strategjitë e partive politike në Maqedoninë e Veriut për pjesëmarrje më të madhe të grave në politikë - 2024 Gjetjet në: <https://www.wfd.org/what-we-do/resources/political-parties-strategies-enhancing-womens-political-participation-north>*

Metodologjia

Procesi i mbledhjes së të dhënave për përgatitjen e kësaj analize u zhvillua në periudhën prill – qershor 2024, përkatësisht me fillimin e fushatës zgjedhore për zgjedhjet presidenciale, përfshirë fushatën për zgjedhjet parlamentare dhe raundin e dytë të zgjedhjeve presidenciale, të cilat përkuan me zgjedhjet parlamentare, me konstituimin e përbërjes së re parlamentare dhe formimin e përbërjes së re të Qeverisë. Për të arritur qëllimin e hulumtimit, u përdor një metodë cilësore për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave parësore dhe dytësore, duke zbatuar instrumentet e mëposhtme kërkimore:

- analiza e përmbajtjes, e cila mbuloi rishikimin dhe analizën sistematike të legjislacionit dhe dokumenteve strategjike, raporteve, hulumtimeve dhe analizave, për të portretizuar situatën e pjesëmarrjes politike të grave. Janë analizuar shkalla e zbatimit të përpjekjeve të partive politike, programet zgjedhore, materialet promovuese, faqet e internetit të nëntë partive politike, përkatësisht të koalicioneve, dhe profilet e tyre në mediat sociale, si dhe përmbajtje mediatike në lidhje me fushatat zgjedhore;
- pyetësorë gjysmë të strukturuar, me të cilët janë kryer gjithsej tetë intervista online / telefonike me përfaqësues/e të partive politike. Përmes intervistave, u mblodhën informacione mbi situatën aktuale me angazhimet e deklaruara, duke përdorur gjithashtu përmbledhjet me shkrim të paraqitura nga vetë partitë para konferencës dhe informacionet e siguruara gjatë konferencës.

Pjesëmarrja politike e grave në Maqedoninë e Veriut

Republika e Maqedonisë së Veriut, si nënshkruese e Deklaratës së Pekinit dhe Platformës për Veprim, si dhe e Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW), është e angazhuar për përmirësimin e statusit të grave dhe fuqizimin e tyre, përfshirë në jetën publike dhe proceset e vendimmarrjes. Për më tepër, legjislacioni kombëtar, i cili duhet të harmonizohet me dispozitat e dokumenteve ndërkombëtare në të cilat shteti është nënshkrues, është një mjet i rëndësishëm për promovimin e barazisë gjinore dhe pjesëmarrjen e grave në politikë. Megjithatë, zbatimi efektiv i këtyre ligjeve është thelbësor për shndërrimin e detyrimeve në progres të prekshëm, duke siguruar pjesëmarrje të konsiderueshme të grave në të gjitha aspektet e shoqërisë dhe duke nxitur proceset gjithëpërfshirëse të vendimmarrjes.

Në vitin 2002, për herë të parë në Maqedoninë e Veriut, u prezantua një kuotë gjinore⁶ që kërkon që 30% e kandidatëve në listat zgjedhore në nivel kombëtar dhe lokal të jenë të gjinisë më pak të përfaqësuar, e cila në vitin 2006 u zgjerua dhe kërkon që çdo person i tretë në listat e kandidatëve të jetë i gjinisë më pak të përfaqësuar. Një nga kontributet më të rëndësishme në përmirësimin e legjislacionit kombëtar të Maqedonisë së Veriut ishin ndryshimet në Kodin zgjedhor në vitin 2015. Në nenin 64, u prezantua detyrimi për partitë politike në listën e

6 Kuotat gjinore janë një instrument për masa pozitive që synojnë arritjen e pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të balancuar gjinor përmes vendosjes së një proporcioni (përqindje) të përcaktuar saktësisht ose numrin e vendeve që do t'u ndahen grave dhe/ose burrave, kryesisht sipas rregullave ose kritereve të caktuara. (Kuvendi i RMV-së. (2020). *Plani i aktiviteteve për promovimin e ndjeshmërisë gjinore të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut 2020-2021.*)

paraqitur të kandidatëve për deputetë dhe anëtarë të këshillit të komunës dhe qytetit të Shkupit, të paktën 40% e kandidatëve të propozojnë gjininë më pak të përfaqësuar, si më poshtë: në çdo tre vende të paktën një vend i takon gjinisë më pak të përfaqësuar dhe përveç kësaj të paktën një vend në çdo dhjetë vende. Megjithatë, përkundër rritjes së përfshirjes së grave në sferën publike në Maqedoninë e Veriut në vitet e fundit, arritja e barazisë gjinore është ende një sfidë e rëndësishme për vendin. Gratë vazhdojnë të jenë dukshëm më pak të përfaqësuar në proceset e vendimmarrjes dhe faktorë të tillë si hendeku gjinor i pagave, përgjegjësitë joproporcionale të kujdesit në shtëpi dhe rreziku i dhunës me bazë gjinore pengojnë shumë pjesëmarrjen e tyre të plotë. Qëndrimet dhe normat patriarkale të ngulitura thellë ende mbajnë fort ndarjen tradicionale të roleve gjinore, duke penguar kështu rrugën e grave drejt dhe përmes strukturave të pushtetit. Si rezultat, gratë përballen me diskriminim të shumëfishtë, varësi ekonomike, duke marrë parasysh se vetëm 28% e grave në vend posedojnë pasuri të patundshme, një përhapje të lartë të dhunës me bazë gjinore, që prek 1 në 5 gra të moshës nën 50 vjeç dhe ngarkesa disproporcionale e punës dhe përgjegjësi të papaguara për kujdes, të cilat janë 2,6 herë më të mëdha se ato që i ndërmarrin burrat.⁷

Në vëzhgimet përmbyllëse mbi situatën në Maqedoninë e Veriut në vitin 2018, Komiteti CEDAW theksoi përfaqësimin e pamjaftueshëm të grave në sektorë të ndryshëm të jetës publike, duke përfshirë Kuvendin, Qeverinë, këshillat komunale, postet e kryetarëve të komunave, rolet vendimmarrëse në shërbimin diplomatik dhe gjyqësorin, duke ia atribuar këtë dallim stereotipeve të vazhdueshme diskriminuese gjinore që mbizotërojnë në shoqëri.⁸ Kështu, konsiderohet se përfaqësimi i ulët i grave në degën ekzekutive në nivel kombëtar dhe

7 Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut. (2021). *Nuk ka kuota - nuk ka gra? Gjendet në: <https://mhc.org.mk/news/nema-kvoti-nema-zheni/>*

8 CEDAW. (2018). *Concluding observations on the sixth periodic report of the former Yugoslav Republic of Macedonia. Në dispozicion në: https://tbinternet.ohchr.org/_layouts/15/treatybodyexternal/Download.aspx?symbolno=CEDAW/C/MKD/CO/6&lang=En*

lokal rrjedh nga diskriminimi sistematik i grave në partitë politike, në të cilat shumë rrallë gratë zënë pozita në udhëheqjen e partisë.⁹

Disa nga këto vëzhgime u vunë në dukje edhe në raportin përfundimtar të ODIHR-it për zgjedhjet e fundit parlamentare në vitin 2020, duke shtuar se gratë janë më pak të përfaqësuara në mbulimin mediatic të fushatave, përkatësisht se pavarësisht se përbëjnë 42% të kandidatëve të regjistruar, mbulimi i grave politikane nga media ndryshon midis vetëm 4% dhe 14%.¹⁰ Për më tepër, kandidatet femra treguan mungesë mbështetjeje për lideret e mundshme femra në strukturat brenda partisë.¹¹

Në përbërjen e fundit¹² të Kuvendit, falë kuotës së detyrueshme gjinore prej 40%, deputetet femra përfaqësonin 42% të totalit, përkatësisht 51 nga 120 vendet ishin të plotësuara me gra. Nga ana tjetër, Qeveria përbëhej nga një kryeministër, katër zëvendëskryeministra dhe 16 ministra, dhe vetëm katër gra (20%) në pozicione kyçe. Megjithatë, dështimi më i madh është vërejtur në zgjedhjet lokale të vitit 2021, në të cilat nga gjithsej 299 kandidatë për kryetarë komunash, vetëm 8% ishin gra, nga të cilat në fund vetëm 2 nga 79 kryetarë të zgjedhur ishin gra, përkatësisht 2,5%. Përveç kësaj, megjithëse gratë përbënin rreth 45% të të gjithë kandidatëve për këshilltarëve, ato kryesonin vetëm 19% të listave të kandidatëve. Këto rezultate mbresëlënëse ngjajnë shumë me rezultatet e zgjedhjeve lokale të njëzet viteve më parë dhe tregojnë për përjashtimin e grave atje ku nuk parashikohen kuota gjinore.

Ajo që mund të vërehet në vitet e fundit është se disa nga partitë politike në fushatat zgjedhore kanë filluar të shprehin angazhimin për barazi më të madhe gjinore dhe për promovim të pjesëmarrjes më të madhe të grave. Sidoqoftë, praktika aktuale tregon se pas

9 UN Women. (2023). *Profili i barazisë gjinore në Maqedoninë e Veriut. Në dispozicion në:* https://eca.unwomen.org/sites/default/files/2023-09/unw_cgcp_nmk_mk_web.pdf

10 ODIHR. (2020). *REPUBLIC OF NORTH MACEDONIA EARLY PARLIAMENTARY ELECTIONS 15 July 2020, ODIHR Special Election Assessment Mission Final Report. Gjendet në:* <https://www.osce.org/odihr/elections/north-macedonia/465642>

11 Ibid.

12 Deri në shpërndarjen e Kuvendit, para mbajtjes së zgjedhjeve parlamentare.

zgjedhjeve, detyrimi për këto përpjekje zbutet, më së shpeshti nën pretekstin e ekzistencës së çështjeve të tjera sociale “prioritare”. Në të njëjtën kohë, duke pasur parasysh se nga partitë politike barazia gjinore perceptohet si prioritet në vetvete, domethënë nuk trajtohet si një qasje për zbatimin e perspektivës gjinore në të gjitha aspektet e jetës shoqërore, angazhimet zgjedhore shpesh reduktohen vetëm në deklarata deklarative nga partitë që nuk sjellin ndryshime pozitive. Prandaj, është e nevojshme jo vetëm t’i qasemi barazisë gjinore në mënyrë deklarative dhe ta përdorim atë vetëm për të mbledhur pikë politike në fushatat zgjedhore, por edhe që partitë politike të ndërmarrin angazhime serioze dhe të fillojnë të veprojnë në drejtim të realizimit të saj.

Angazhimet për barazi gjinore përkundrejt pamjes reale

Në kuadër të konferencës “Dhuna ndaj grave në politikë - zgjidhje për forcimin e pjesëmarrjes politike të grave”, nëntë parti politike shprehën përpjekjet e tyre për të siguruar përfaqësim dhe pjesëmarrje më të madhe të grave në politikë në Maqedoninë e Veriut. Angazhimet e ndërmarra nga partitë politike mbuluan një gamë të gjerë masa dhe strategji për promovimin e barazisë gjinore në politikë. Ky seksion tregon angazhimet e ndërmarra nga partitë politike, në krahasim me të dhënat e mbledhura për qëllime të kësaj analize, me qëllim vlerësimin e shkallës së miratimit dhe zbatimit të angazhimeve për barazi gjinore gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet presidenciale dhe parlamentare, si dhe pasqyrimi i tyre mbi rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve.

Parimi i barazisë gjinore në politikat dhe programet partiake

Megjithëse barazia gjinore është e pranishme në shumicën e programeve zgjedhore partiake, përmes masave të ndryshme, megjithatë angazhimi për barazi gjinore në disa raste trajtohet përmes disa ose vetëm një, masë/masave konkrete, si pjesë e një game më të gjerë masash të destinuara për të gjitha sferat e tjera, më së shpeshti në fushën e të drejtave të njeriut. Megjithëse përparësia e parimit të barazisë gjinore mund të vërehet në më shumë se gjysmën e politikave dhe programeve partiake, disa nga partitë ende përqendrohen në rolin tradicional gjinor të grave. Kjo është e dukshme përmes politikave të caktuara demografike që, pavarësisht se shoqërohen me masa

për pavarësinë ekonomike të grave, ende nuk e njohin rolin e grave si ofruesi kryesor i kujdesit në familjen maqedonase, përkatësisht ato nuk parashikojnë masa për të siguruar një ekuilibër midis jetës private dhe profesionale, pa të cilën pavarësia ekonomike e grave është pothuajse e pamundur.

Në programin zgjedhor të njëjës nga partitë, parimi i barazisë gjinore nuk zbatohet fare, domethënë nuk përmban angazhime për barazi gjinore, dhe gjinia përmendet vetëm si një nga bazat për barazi në fushën e mundësive të barabarta në sferën e ekonomisë.

Barazia gjinore në partitë politike

Intensiteti i detyrimeve dhe aktiviteteve në lidhje me fushatat zgjedhore që u zhvilluan në periudhën e kufizuar që ishte objekt i analizës ishte një nga arsyet pse partitë politike nuk kishin arritur pjesën më të madhe të përpjekjeve në lidhje me promovimin e barazisë gjinore në kuadër të organizimit të tyre të brendshëm. Prandaj, në periudhën e kaluar, partitë politike nuk i janë qasur përkufizimit dhe/ose rritjes së kuotave gjinore në organet e brendshme të partisë, por disa prej tyre kanë deklaruar se zbatojnë strategji të ndryshme formale dhe joformale për të mbështetur gratë politike. Këto strategji përfshijnë takime konsultative me kryetarët/et e sektorëve të partisë për të përfshirë më shumë gra, aktivitete në terren me organizatat lokale të grave, vizita në terren dhe paraqitje publike duke u kujdesur që të ketë përfshirje të barabartë të grave dhe burrave nga partia, etj.

Katër parti në kuadër të programit të përbashkët zgjedhor avokojnë për investime strategjike, financim dhe mbështetje të grave në pozita udhëheqëse në politikë, si dhe zhvillimin e mekanizmave dhe trajnimeve që do të inkurajonin vajzat dhe gratë e reja të marrin pjesë në procesin zgjedhor dhe aktivitetet politike, dhe fuqizimin politik të grave për të ndërmarrë detyra publike nëpërmjet zhvillimit dhe ofrimit të mjeteve dhe aftësive përkatëse.

Shumica e përfaqësuesve të intervistuar të partive deklaruan se janë të vetëdijshëm për dominimin e burrave si udhëheqës të partive,

përkatësisht se edhe në rastet kur politikat diskutohen/miratoohen me pjesëmarrjen e grave, siç është përfshirja e forumeve partiake të grave, vendimi përfundimtar ende merret nga udhëheqësi i partisë i cili është kryesisht një person mashkull. Nga nëntë partitë politike që ishin pjesë e kësaj analize, vetëm dy udhëheqës të partive janë femra. Sipas deklaratave të të intervistuarve, në partitë politike ku gruaja është kryetare, përfshirja e grave dhe përpjekjet për barazi gjinore në parti kuptohen dhe, pavarësisht institucionalizimit të tyre brenda partisë, ndodhin në mënyrë “të natyrshme”. Pikërisht në një nga këto parti anëtarësia përbëhet nga shumicë e grave. Për më tepër, nga 17 parti ose koalicione që kishin paraqitur lista zgjedhore në zgjedhjet parlamentare, vetëm dy drejtoheshin nga gra.¹³

Megjithëse jo gjithmonë kanë një rol të rëndësishëm në procesin e vendimmarrjes në parti, forumet, përkatësisht organizatat e grave brenda partive politike, përfaqësojnë një faktor të rëndësishëm (shumë shpesh dhe unik) në parti për inicimin dhe arritjen e përpjekjeve për barazi gjinore. Nëpërmjet forumeve të grave, propozimet për zgjidhje të caktuara ligjore që lidhen me promovimin e barazisë gjinore diskutohen shpesh në mënyrë ndërpartiake. Dhe, megjithëse në përgjithësi forumet gëzojnë mbështetje, shpesh financiarisht, nga partia, megjithatë në dy nga intervistat u theksua nevoja për pavarësi financiare të forumeve, në mënyrë që të rrisin kompetencën e tyre politike, por shumë më tepër për të rritur efektin dhe dukshmërinë e punës së tyre. Në një nga intervistat, u tha se shpesh ndodh që gratë në parti në prapavijë të bëjnë punën, rezultatet e së cilës më vonë u atribuohen burrave në parti që janë në pozita më të larta, megjithatë, heqja e forumeve të grave si seksione të veçanta brenda partive, përmes të cilave shpesh bëhet segregimi i politikaneve femra, nuk është e arritshme për sa kohë që niveli i ndërgjegjësimit për përfshirjen e grave në politikë, veçanërisht në proceset e vendimmarrjes, është i ulët.

13 I referohet një gruaja në pozicionin drejtues të partisë ose koalicionit që kandidon në zgjedhjet parlamentare.

Pjesëmarrja në Kuvend

Megjithëse pothuajse gjysma e programeve të analizuara të partive parashikojnë një rritje të kuotave gjinore për përfaqësimin e grave në listat parlamentare në 50%, përfaqësimi i grave në listat e kandidatëve për zgjedhjet parlamentare të këtij viti nuk e pasqyron në mënyrë adekuate këtë angazhim.

Analiza e listave parlamentare për zgjedhjet parlamentare zbuloi se të gjitha partitë përmbushin detyrimin ligjor për përfaqësim minimal prej 40% të gjinisë më pak të përfaqësuar, pra në këtë rast gratë, ku një kandidat i gjinisë më pak të përfaqësuar duhet të përfshihet në mesin e çdo tre kandidatëve të njëpasnjëshëm, me të paktën një kandidat shtesë të kësaj gjinie për çdo dhjetë kandidatë. Megjithatë, analiza tregon gjithashtu se numri i grave rritet më tej më poshtë në listat. Ndërsa gratë përbënin 43% të të gjithë kandidatëve për deputete, ato shpesh vendoseshin në pozicionet më të ulëta të lejuara nga ligji.¹⁴

Prandaj, midis të gjitha partive të analizuara, ka një prani më të ulët të grave në pesë vendet e para në listat e kandidatëve, gjë që i bën ato më pak të mundshme për t'u votuar. Edhe në katër nga partitë që kanë pjesëmarrjen më të lartë të grave në listat e kandidatëve, në pesë vendet e para pjesëmarrja e grave është 36.7%, ndërsa në pesë vendet e dyta 60%. Partitë e tjera kanë një pjesëmarrje të grave prej 30% dhe më pak në pesë vendet e para në listat e kandidatëve. Kjo pasohet nga situata me bartësit e listave të kandidatëve, ku vetëm tre gra janë bartëse të listave parlamentare, përkatësisht 12.5% e nëntë partive që u përfshinë në këtë analizë. Për më tepër, nga gjithsej 84 lista deputetësh që u paraqitën në KSHZ për zgjedhjet parlamentare, vetëm 21 bartës të listës janë gra (25%).

Disa nga partitë kanë futur kohët e fundit të ashtuquajturin parim të bashkë-nominimit në listat e kandidatëve, që nënkupton se kandidati i

14 ODIHR. (2024). *North Macedonia, Parliamentary Elections and Presidential Election – Second Round, 8 May 2024: Statement of Preliminary Findings and Conclusions*. Gjen-det në: <https://www.osce.org/odihr/elections/north-macedonia/568270>

parë dhe i dytë në listë duhet të jetë një burrë dhe një grua, domethënë, nëse i pari në listë është një burrë, i dyti duhet të jetë një grua dhe anasjelltas. Megjithatë, ekziston një keqinterpretim i këtij parimi nga partitë, duke qenë se ligji nuk njeh bashkë - bartësin, ku vetëm një person mund të jetë bartës ose mbajtës i një liste kandidatësh, ndërsa të ashtuquajturit bashkë-bartës janë të dytët në lista dhe, si të gjithë kandidatët në lista, varen nga numri i votave të marra për partinë në një njësi të caktuar zgjedhore. Nëse bartësi ose bartësja i/e listës merr vota të mjaftueshme për një vend parlamentar, kjo nuk do të thotë që personi që është i dyti në listë merr automatikisht një vend parlamentar. Ajo që është veçanërisht e rëndësishme është që kjo mënyrë e paraqitjes së bashkë-kryesimit, nuk duhet të përdoret si pretekst për dominimin e burrave në krye të listave për kandidatë.

Në dy intervista u deklarua se niveli i ndërgjegjësimit për kandidaturën e grave në listat zgjedhore varet shumë nga mjedisi ose madhësia e organizatës komunale. Prandaj, organizatat më të vogla/komunat rurale më shpesh emërojnë vetëm kandidatë meshkuj.

Në rastin e një partie politike, listat zgjedhore për zgjedhjet parlamentare u përpiluan në mënyrë shumë jotransparente, pa konsultime dhe mundësinë e sugjerimit nga gratë në parti, dhe u publikuan një ditë para dorëzimit të tyre në KSHZ.

Nga ana pozitive, njëra nga partitë që ka një kuotë të brendshme gjinore prej 30% përfaqësim në listat zgjedhore ka 50% përfaqësim gjinor, përkatësisht janë zgjedhur një deputet dhe një deputet.

Pushteti ekzekutiv dhe lokal

Pothuajse të gjithë përfaqësuesit e intervistuar dhe përfaqësuesit e partive politike besojnë se kuotat gjinore janë ende të nevojshme për përfshirjen e grave në nivele të ndryshme të qeverisjes, veçanërisht duke pasur parasysh se aty ku nuk ka kuota gjinore, numri i grave është dukshëm i ulët, si në pushtetin ekzekutiv dhe në pushtetin lokal.

Nga të analizuarat, tetë parti politike mbrojnë vendosjen e kuotave gjinore në të gjitha pozicionet ekzekutive, ndërsa shtatë prej tyre e

kanë përfshirë këtë angazhim në programet zgjedhore. Megjithatë, pavarësisht këtyre përpjekjeve, përbërja e re e Qeverisë, e cila u krijua më 23 qershor 2024,¹⁵ vetëm deklarativisht konfirmoi mbështetjen e këtyre përpjekjeve. Megjithëse pak para formimit të Qeverisë së re, ministritë u riorganizuan, të cilat u rritën nga 16 në gjithsej 20, me të cilat Qeveria përbëhet nga gjithsej 24 anëtarë, vetëm tre gra (12.5%) u bënë pjesë e Qeverisë në tre pozicione ministrore, që është rreth 8% më pak se përbërja e mëparshme e Qeverisë. Shumica e përfaqësueseve dhe përfaqësuesve të partive, përfshirë edhe ata që janë pjesë e Qeverisë, thanë se në periudhën e ardhshme do të vazhdojnë të punojnë në përmirësimin e përfaqësimit të grave në pozita ministrore, kryesisht përmes iniciativave për futjen e kuotave gjinore për përbërjen e Qeverisë.

Kur bëhet fjalë për pushtetin lokal, katër parti në programet e tyre zgjedhore angazhohen për vendosjen e kuotave gjinore prej 50% për listat e këshillave dhe 30% kandidatë gra për kryetarë të komunave, ndërsa tre parti parashikojnë kuota gjinore prej të paktën 40% në të gjitha nivelet, duke përfshirë edhe pozicionet e kryetarëve të komunave. Kështu, disa nga partitë konfirmuan se po punojnë për zhvillimin e nismave legislative specifike për arritjen e këtyre angazhimeve dhe planifikojnë t'i paraqesin me hapjen e Kodit Zgjedhor në periudhën e ardhshme, para zgjedhjeve të ardhshme lokale në vitin 2025. Shumica e partive janë të vetëdijshe për mungesën e grave në pozita të kryetarëve të komunave dhe besojnë se duhet të gjendet një zgjidhje e përshtatshme për këtë problem. Tre nga të intervistuarit deklaruan se praktika e emërimit të grave në nivel lokal për të plotësuar vendet e kandidatëve vlerësohet se ka vota të pamjaftueshme duhet të zvogëlohet.

Tre parti brenda programit të tyre zgjedhor janë të angazhuara për diskriminim pozitiv për pozitat konkurruese në konkurset publike, përkatësisht në rastet kur pikët janë të barabarta, gjinia më pak e

15 Në dispozicion në: <https://vlada.mk/vlada-ministerstva>

pranishme në secilën punë do të favorizohet, gjë që u konfirmua gjatë intervistave.

Avancimi i legjislacionit

Më shumë se gjysma e programeve të analizuara të partive parashikojnë disa iniciativa legjislative në fushën e barazisë gjinore. Në të njëjtën kohë, katër parti avokojnë për miratimin e Ligjit të ri për barazi gjinore, si dhe Kodin e ri zgjedhor me vendosjen e parimit 50-50, përkatësisht kuotë gjinore prej 50% për listat parlamentare dhe të këshillave në komunat dhe Qytetin e Shkupit, si dhe një 30% të detyrueshme gra candidate për kryetare komunash. Megjithatë, një nga të intervistuarit deklaroi se megjithëse partia e tyre kishte paraqitur tashmë këto ndryshime të propozuara në Kodin zgjedhor para zgjedhjeve parlamentare, ata nuk kishin gjetur mbështetjen e partive të tjera me pretekstin se nuk kishte kohë të mjaftueshme për votimin e tyre në Kuvend.

Pesë nga partitë angazhohen për mbrojtjen ligjore të grave fermere, kryesisht në drejtim të sigurimit shëndetësor dhe pushimit të lehonisë. Shtatë parti parashikojnë ndryshime legjislative për të përmirësuar statusin dhe mbrojtjen e grave punëtore. Pesë parti parashikojnë përmirësimin e legjislacionit në lidhje me mbrojtjen e grave nga dhuna, ndërsa katër parti theksojnë nevojën për përafrimin e mëtejshëm të ligjeve me Konventën e Stambollit. Katër parti mbrojnë vendosjen e edukimit gjithëpërfshirës seksual, ndërsa dy parti mbrojnë miratimin e kuadrit ligjor për njohjen ligjore të gjinisë.

Dukshmëria e politikeve femra

Si pjesë e fushatës zgjedhore, u detektua një përfaqësim përgjithësisht i ulët i narrativës gjinore, por edhe i grave politikeve. Megjithëse disa nga partitë politike kishin dukshmëri më të lartë të grave, fokusi ishte ende te udhëheqësit e partive dhe/ose të koalicionit, shumica e të

cilëve ishin burra. Edhe ato parti që kanë një grua kryetare, u lanë kryesisht në hije nga udhëheqësit e partive më të mëdha si partnerët e tyre të koalicionit. Me përjashtim të dukshëm të një kandidateje për presidente femër në raundin e dytë, pak politikanë femra u përfshinë në fushata në përgjithësi.¹⁶ Anëtarët meshkuj të partive ishin më shpesh aktivë në promovimin dhe mbështetjen e barazisë gjinore duke mbështetur gratë që ishin kandidate për pozicionin presidencial ose si bartëse të listave të kandidatëve.

Analiza e narrativës në fushatat zgjedhore tregon se shumica e partive nuk përdorin fjalim të ndjeshëm ndaj gjinisë, i cili është veçanërisht i dukshëm përmes përdorimit të rrallë të feminitivave, madje vërehet përdorimi i fjalës seksiste nga disa prej partive në akuzat e ndërsjella partiake gjatë paraqitjeve publike. Disa parti nuk përdorën fare termat «gjini» dhe «barazi gjinore», ndërsa njëra parti përqendrohet në përdorimin e termave «gjini» dhe «barazi gjinore», gjë që mund të çojë në një kuptim të ngushtë të barazisë që neglizhon aspektet sociale dhe kulturore të diskriminimit dhe është kritike për trajtimin e çështjeve të stereotipeve, roleve dhe normave që ndikojnë në barazi. Çështjet që lidhen me barazinë gjinore u neglizhuan kryesisht në diskursin e fushatës, me përjashtim të një kandidate presidenciale.¹⁷

Në shumicën e ngjarjeve të tjera, referencat në lidhje me gratë i referoheshin roleve të tyre brenda familjes, duke reflektuar kështu stereotipet gjinore dhe diskriminimin ndaj familjeve jo-tradicionale.¹⁸ Sipas analizës së mbulimit mediatik gjatë fushatës zgjedhore, portretizimi i vendosur i politikanëve femra përmes rolit të tyre në familje ose pamjes së tyre, si dhe transmetimi jokritik i deklaratave diskriminuese gjinore nga politikanë të tjerë, kontribuon ndjeshëm në forcimin e roleve gjinore dhe mbajtjen e qëndrimeve misogjiniste rreth

¹⁶ ODIHR. (2024). *North Macedonia, Parliamentary Elections and Presidential Election - Second Round, 8 May 2024: Statement of Preliminary Findings and Conclusions*. Gjen-det në: <https://www.osce.org/odihr/elections/north-macedonia/568270>

¹⁷ Ibid.

¹⁸ Ibid.

rolit të grave në sferën publike.¹⁹ Për më tepër, në një dalje publike nga një prej liderëve të partisë, u vu re përdorimi i seksizmit dhe ejxhizmit ndaj një kandidate presidenciale.²⁰

Gjatë kësaj fushate zgjedhore, komentet nga publiku me seksizëm dhe gjuhë urrejtjeje me bazë gjinore drejtuar politikaneve femra mund të vëreheshin në llogaritë e mediave sociale partiake. Këto komente negative më së shpeshti shfaqen në postime që përfshijnë deklarata nga politikane femra dhe ajo që është më shqetësuese është se një pjesë e madhe e tyre janë ende të dukshme për publikun, përkatësisht ato nuk fshihen nga personi që administron profilin.

19 Jovanovska, B. dhe Milenkovska, S. (2024). *Analiza e përmbajtjeve me bazë gjinore: Politikanët dhe paragjykimet e mediave. Në dispozicion në: https://iks.edu.mk/istrazuwanja-analizi/analiza-na-rodovo-bazirani-sodrzhini-politich-arkite-i-mediumskata-pristrasnost/?fbclid=IwZXh0bgNhZW0CMTAAAR0vQc9-Xniq-8F2Lm_9bPS-wpN4tu7e6RdAV2mn5Af-UKvf92_9tKeFDIGw_aem_3St1us6rZeXqA-ict3aCqA*

20 Ibid.

Përfundime dhe rekomandime

Nga të dhënat e siguruar përmes analizës së programeve partiake dhe raporteve të mediave, si dhe deklaratave të bëra nga përfaqësueset dhe përfaqësuesit e partive, në përgjithësi mund të konkludojmë se përpjekjet për të siguruar përfaqësim dhe pjesëmarrje më të madhe të grave në politikë në Maqedoninë e Veriut ishin kryesisht. Megjithëse partitë politike po bëjnë përpjekje për përfshirje më të madhe të grave politike dhe zbatimin e parimit të barazisë gjinore në çdo sferë të shoqërisë, megjithatë, në një kohë krize politike dhe ekonomike, barazia gjinore përsëri nuk e gjen vendin e saj në mesin e prioriteteve të partive politike.

Angazhimi për barazi gjinore në kuadër të programeve të partive politike ndryshon ndjeshëm, duke ndikuar në efektivitetin e përpjekjeve për të promovuar barazinë gjinore. Ndërsa më shumë se gjysma e partive i japin përparësi barazisë gjinore në politikën e tyre, qasja shpesh nuk ka masa gjithëpërfshirëse, duke kufizuar kështu potencialin për përparim kuptimplotë. Politikën që vazhdojnë të forcojnë rolet tradicionale gjinore minojnë hapat e bërë drejt arritjes së barazisë së vërtetë gjinore, veçanërisht duke mos mbështetur ekuilibrin punë-jetë. Neglizhimi i barazisë gjinore në programin zgjedhor të një partie tregon një mundësi të humbur për promovimin gjithëpërfshirës të të drejtave dhe fuqizimin e grave.

Për të forcuar angazhimin për barazi gjinore, partitë politike duhet të integrojnë masa gjithëpërfshirëse të barazisë gjinore në politikën dhe programet e tyre përtej gjesteve të thjeshta simbolike, dhe t'i zbatojnë ato në mënyrë të përshtatshme dhe në kohën e duhur. Kjo përfshin përcaktimin e objektivave të qarta, afateve kohore dhe një buxheti adekuat për iniciativat e barazisë gjinore, si dhe sigurimin e një perspektive gjinore në hartimin e të gjitha politikave të tjera. Partitë

duhet t'i japin përparësi barazisë gjinore në të gjitha sferat e qeverisjes dhe të njohin rolet e ndryshme të grave përtej stereotipeve tradicionale, duke siguruar një sigurim gjithëpërfshirës të pavarësisë ekonomike dhe ekuilibrit punë-jetë.

Megjithëse partitë politike kanë përfshirë angazhime për barazi gjinore në fushatat e tyre zgjedhore, ato nuk janë zbatuar plotësisht në organizatat e tyre të brendshme. Shumica e partive nuk kanë arritur të përcaktojnë ose rrisin kuotat gjinore në trupat e tyre të brendshëm, megjithëse disa zbatojnë strategji të caktuara për të mbështetur gratë politike. Ndërsa katër parti mbrojnë investimet strategjike dhe trajnimin për gratë në udhëheqje, dominimi i udhëheqësve meshkuj në proceset e vendimmarrjes vazhdon. Partitë politike, udhëheqësit e të cilave janë gra, kanë një shkallë më të lartë të barazisë gjinore në vetë partitë, si dhe i japin përparësi parimit të barazisë gjinore në punën e tyre. Forumet e grave në parti shërbejnë si mjete jetike për të promovuar barazinë gjinore, por shpesh nuk kanë pavarësi financiare dhe kontributet e grave ndonjëherë janë lënë në hije nga kolegët e tyre meshkuj.

Partitë politike duhet të ndërmarrin hapa konkretë për të përmirësuar barazinë gjinore brenda strukturave të tyre të brendshme, duke institucionalizuar parimin e barazisë gjinore brenda partive. Kjo përfshin vendosjen dhe/ose respektimin e kuotave gjinore në udhëheqjen e partisë dhe organet vendimmarrëse, si dhe zhvillimin e sistemeve formale dhe joformale për të mbështetur gratë politike. Për më tepër, partitë duhet të promovojnë udhëheqjen e grave duke investuar në programe trajnimi dhe mentorimi për gratë, duke siguruar pjesëmarrjen e tyre aktive në proceset e vendimmarrjes, duke përfshirë inkurajimin dhe mbështetjen e grave për pozicionet më të larta të partisë. Duhet të inkurajohet pavarësia financiare e forumeve të grave në parti në mënyrë që të rritet efektiviteti dhe dukshmëria e tyre, si dhe pjesëmarrja aktive në proceset e vendimmarrjes në nivel të partisë.

Ndërsa partitë politike plotësojnë ligjërisht kërkesën për të pasur të paktën 40% të gjinisë më pak të përfaqësuar në listat e tyre të kandidatëve për zgjedhjet parlamentare, gratë shpesh vendosen në

pozita më të ulëta, me më pak gjasa për tu votuar, gjë që minon shanset e tyre që të zgjidhen. Kjo praktikë zbulon një hendek midis angazhimit formal për barazinë gjinore dhe zbatimit të saj thelbësor, duke reflektuar vetëm përfshirjen sipërfaqësore që pengon progresin real. Disa hapa që paraqiten si pozitivë në drejtim të barazisë më të madhe gjinore, siç është parimi i bashkë - bartësit, janë keqpërdorur, duke mos arritur të sfidojnë në mënyrë efektive dominimin mashkullor në listat e kandidatëve për zgjedhjet parlamentare. Kjo pabarazi e vazhdueshme kufizon potencialin për një organ parlamentar të ekuilibruar dhe të larmishëm, i cili është kritik për vendimmarrjen gjithëpërfshirëse dhe përfaqësuese.

Për të përmirësuar përfaqësimin gjinor në Kuvend, partitë duhet të zbatojnë angazhimet e dhëna më parë për të rritur kuotën gjinore në 50% për përfaqësimin e përfaqësueseve dhe përfaqësuesve parlamentarë, gjë që do të jetë gjithashtu një pasqyrim shumë më i përshtatshëm i strukturës gjinore të popullsisë maqedonase. Për më tepër, partitë duhet të angazhohen për vendosjen e grave kandidate në pozita më të larta në listat zgjedhore. Kjo përfshin respektimin e kuotave gjinore jo vetëm “në letër”, gjë që do të sigurojë pozicionimin e grave në krye të listave të kandidatëve. Partitë, gjithashtu duhet të marrin në konsideratë rishikimin e parimit të bashkë-bartësit në listat e kandidatëve në mënyrë që të shmangin keqinterpretimin dhe të sigurojnë përfshirjen kuptimplotë të grave. Në të njëjtën kohë, është e nevojshme të punohet në rritjen e ndërgjegjësimit të organizatave komunale më të vogla/rurale në lidhje me përfshirjen e grave në politikë dhe kandidaturën e tyre në nivel të organizatave komunale.

Përkundër njohjes së gjerë të domosdoshmërisë së kuotave gjinore në pozita në pushtetin ekzekutiv dhe pushtetin lokal, përfaqësimi aktual i grave mbetet dukshëm i ulët. Përbërja e fundit e Qeverisë, me vetëm 12.5% të pozicioneve ministrore të mbajtura nga gratë, nxjerr në pah hendekun midis angazhimeve dhe aktiviteteve. Ndërsa shumica e partive e njohin nevojën dhe avokojnë për kuota gjinore në nivele të ndryshme të pushtetit lokal, zbatimi i vërtetë është ende një status quo.

Këto boshllëqe nxjerrin në pah nevojën për veprime më konkrete dhe iniciativa legjislative për të përmbushur angazhimet për barazi gjinore.

Partitë politike duhet t'i qasen vendosjes dhe zbatimit të kuotave gjinore në të gjitha nivelet e qeverisjes, duke përfshirë pozitat ekzekutive dhe pozitat e pushtetit lokal, veçanërisht për gratë në pozita ministrore dhe kandidatet për kryetare të komunave. Partitë duhet të zhvillojnë dhe të bëjnë presion për iniciativa legjislative që do të institucionalizojnë këto kuota, përkatësisht përfshirjen e tyre në Kodin zgjedhor dhe Ligjin për Qeverinë. Përveç kësaj, duhet të merren masa për të parandaluar përdorimin strategjik të kandidateve femra vetëm për të plotësuar vendet e kandidatëve që vlerësohet se kanë vota të pamjaftueshme.

Angazhimi për të promovuar barazinë gjinore përmes ndryshimeve legjislative është i dukshëm në shumicën e programeve partiake, por ritmi i reformave të vërteta ligjore mbetet i ngadaltë. Disa parti mbështesin iniciativa të rëndësishme legjislative, siç është Ligji i ri për barazi gjinore dhe vendosja e kuotave gjinore në Kodin zgjedhor, të cilat tregojnë një prirje pozitive drejt formalizimit të barazisë gjinore. Megjithatë, pavarësisht këtyre ambicieve, hapat praktikë drejt reformës ligjore kërkojnë veprim më të fortë dhe më të shpejtë për t'i përkthyer këto përpjekje në ndryshime reale shoqërore.

Përmirësimet ligjore janë thelbësore për avancimin e barazisë gjinore. Partitë politike duhet të punojnë drejt miratimit të ligjeve gjithëpërfshirëse për barazi gjinore dhe reformave zgjedhore që do të sigurojnë përfaqësim të barabartë. Kjo përfshin mbështetjen e mbrojtjes ligjore të grave në sektorë të ndryshëm, si: bujqësia, marrëdhëniet e punës, mbrojtja nga diskriminimi, përmirësimi i legjislacionit për mbrojtjen e grave nga dhuna.

Fushata zgjedhore tregoi një mungesë të konsiderueshme të narrativës gjinore dhe dukshmërisë së politikaneve femra, me pjesën më të madhe të fokusit të mbetur tek udhëheqësit meshkuj të e partive politike. Megjithëse disa parti treguan dukshmëri më të madhe të grave, ndikimi i përgjithshëm u la në hije nga koalicionet më të mëdha të partive të udhëhequra kryesisht nga burrat. Përdorimi i kufizuar i

gjuhës së ndjeshme gjinore, së bashku me rastet e retorikës seksiste, nxjerr në pah çështjen e vazhdueshme të diskriminimit gjinor dhe stereotipeve në diskursin politik. Ky përfaqësim i papërshtatshëm, i mbështetur nga forcimi mediatik i roleve tradicionale gjinore, e bën të vështirë përparimin drejt barazisë gjinore në sferën politike.

Për të përmirësuar dukshmërinë dhe ndikimin e grave politikane, partitë politike duhet të promovojnë në mënyrë aktive narrativa të ndjeshme gjinore dhe të shmangin përdorimin e stereotipeve gjinore, si dhe fjalimin seksist dhe fytes. Fushatat zgjedhore duhet të theksojnë arritjet dhe aftësitë e kandidatëve femra, duke siguruar një hapësirë në të cilën ato nuk do të jenë nën hijen e kolegëve meshkuj. Përdorimi i gjuhës së ndjeshme gjinore duhet të standardizohet, ndërsa raportimi në media duhet të përqendrohet në kualifikimet profesionale dhe pikëpamjet politike të politikanëve femra, jo në jetën e tyre personale ose pamjen e jashtme. Në të njëjtën kohë, është e nevojshme që komentet në profilet e partive në mediat sociale që përmbajnë gjuhë urrejtjeje me bazë gjinore të moderohen në mënyrë përkatëse, në mënyrë që ky narrativ negativ të mos përhapet më tej, si dhe të mos ndikojë në dekurajimin e politikanëve dhe grave në përgjithësi. Për më tepër, partitë duhet të sigurojnë që çështjet e barazisë gjinore të përfshihen në diskursin e tyre parazgjedhor, duke sfiduar dhe ndryshuar kështu stereotipet gjinore për një kohë të gjatë.

Shtojca

Shtojca 1:

Pyetësor për përfaqësuesit/et e partive politike

Pyetësor për përfaqësuesit/et e partive politike

Përpyqkjet për barazi gjinore në programet zgjedhore të partive politike - Zgjedhjet parlamentare 2024

Data:

Emri dhe mbiemri:

Partia politike:

Pozicioni:


1. Cilat angazhime për barazi gjinore u përfshinë në programin zgjedhor të partisë suaj? Në çfarë mënyre janë parashikuar të zbatohen?
2. Cilat strategji janë zbatuar për të integruar barazinë gjinore në fushatat zgjedhore të partisë suaj?
3. A kishte partia juaj një strategji të veçantë për të inkurajuar dhe mbështetur më shumë gra të marrë pjesë në zgjedhje (trajnim, promovim, dukshmëri, mentorim, financa)? Nëse po, cila ishte strategjia? A ka iniciativa specifike të përshkruara në programin zgjedhor të partisë suaj për të emëruar gratë si kandidatë kryesore dhe për të promovuar historitë e tyre të suksesit?
4. A përfshin programi zgjedhor angazhime për përfaqësim më të madh të grave në Kuvend? Në poste ministrore në pushtetin

ekzekutiv? Në pushtetin lokal? Cilat janë angazhimet dhe si parashikohet arritja e këtij qëllimi?

5. A përfshin programi zgjedhor iniciativa ose ndryshime për të promovuar barazinë gjinore përmes legjislacionit? Cilave ligje u referohet? Çfarë prisni të arrini me to?
6. Shtojca 2 - BRIF NGA KONFERENCA: Strategjitë e partive politike në Maqedoninë e Veriut për pjesëmarrje më të madhe të grave në politikë - 2024

Shtojca 2:

**BRIF NGA KONFERENCA: Strategjitë e partive politike në
Maqedoninë e Veriut për pjesëmarrje më të madhe të
grave në politikë - 2024**



Brif për konferencë:


Strategjitë e partive politike në maqedoninë e veriut për pjesëmarrje më të madhe të grave në politikë

— 2024

Ky doracak është produkt i konferencës me temë “Dhuna ndaj grave në politikë – zgjidhje për pjesëmarrje më të madhe politike të grave”, që u mbajt më 9 shkurt 2024 në Shkup. Ngjarja u organizua nga Fondacioni Westminster për Demokraci (WFD), në partneritet me Institutin për Studime të Komunikimit (ISK) dhe me mbështetjen e Ambasadës Britanike.

Në konferencë, përveç folëses së nderit - deputetes nga Parlamenti i Britanisë së Madhe, znj. Jasmin Qureshi, morën pjesë përfaqësues dhe përfaqësuese të disa partive politike në Maqedoninë e Veriut, së bashku me akademikë, hulumtues/e dhe ekspertë/e të shoqërisë civile. Ngjarja shërbeu si platformë për të diskutuar rolin e financimit të partive politike për rritjen e barazisë gjinore, ndikimin e narrativeve të mediave mbi dhunën ndaj grave në politikë, identifikimin e barrierave ekzistuese në vend, si dhe gjetjen e zgjidhjeve efektive për të forcuar përfaqësimin e grave në politikë.

Qëllimi i këtij brifingu është të shërbejë si një mjet për monitorimin dhe drejtimin e strategjive të ardhshme të partive politike në Maqedoninë e Veriut, drejt pjesëmarrjes më të madhe të grave në politikë.



Gjendjet dhe barrierat për pjesëmarrjen e grave në politikë në Maqedoninë e Veriut

- ✓ Diskriminimi ndaj grave në politikë është ende i pranishëm në vend. Niveli më kritik lokal është aty ku nuk ka kuota gjinore dhe ku ka përfaqësimin më të ulët të grave, me 36.5% këshilltare femra dhe 2.5% kryetare komunë femra. Kjo mospërputhje gjinore është e pranishme në të gjitha partitë, si në nivel organizatash partiake komunale, ashtu edhe në organet qendrore të partive;
- ✓ Vitet e fundit, ka pasur një përfaqësim të barabartë të grave, kryesisht për shkak të respektimit të normave ligjore, por jo përfaqësimi të barabartë të grave në partitë politike;
- ✓ Faktorët tradicionalë dhe fetarë ende kanë një ndikim të rëndësishëm në pjesëmarrjen e grave në politikë;

- ✓ Aspektet sociale dhe ekonomike janë thelbësore për hyrjen e grave në politikë, veçanërisht në nivel lokal, me një nga aspektet kryesore për gratë në politikë që është qasja e tyre në burimet financiare;
- ✓ Ekziston nevoja për të punuar në përmirësimin e statuteve partiake, në drejtim të forcimit të pozitës së grave në parti, për shembull me vendosjen e kuotave gjinore në nivele dhe struktura të ndryshme të partisë;
- ✓ Ekziston nevoja për të përmirësuar pozicionin ligjor të forumeve të grave, veçanërisht në aspektin e pavarësisë së tyre financiare;
- ✓ Është e nevojshme të përmirësohet imazhi i partive politike, për të cilën me rëndësi është përfshirja dhe promovimi i grave në politikë, veçanërisht në nivel lokal.

Angazhimet e partive politike



Duke marrë parasysh rolin e tyre për pjesëmarrjen e grave në politikë, partitë politike në Maqedoninë e Veriut në fjalimet e tyre në konferencë shprehën angazhimin e tyre për sigurimin e përfaqësimit dhe pjesëmarrjes më të madhe të grave në politikë. Fjalimet e tyre janë përmbledhur më poshtë:

- ✓ Përfshirja e parimit të barazisë gjinore në politikë dhe programet partiake, si një nga prioritetet e partisë
- ✓ Përcaktimi dhe/ose rritja e kuotave të brendshme gjinore, në kuadër të Statutit të partive nga 40% në 50% në drejtim të përfaqësimit më të madh të grave në të gjitha nivelet e organeve të partisë;
- ✓ Rritja e kuotave gjinore në 50% për përfaqësimin e grave në listat për deputetë;
- ✓ Vendosja e kuotave gjinore për përfaqësim më të madh të grave në pozicione ministrore në pushtetin ekzekutiv;
- ✓ Vendosja dhe/ose rritja e kuotave gjinore në 50% për përfaqësimin e grave në zgjedhjet lokale, duke përfshirë edhe postet e kryetarëve të komunave;
- ✓ Krijimi i nismave dhe ndryshimeve për avancimin e legjislacionit. Kështu, disa nga partitë avokojnë për një njësi zgjedhore me lista të hapura, me përfaqësim të barabartë të grave dhe burrave;
- ✓ Pjesëmarrje më e madhe në procesin e marrjes së vendimeve partiake dhe forcimin e pavarësisë financiare të forumeve të grave në parti, si dhe forcimin e rolit të tyre, duke krijuar udhëzime dhe aktivitete strategjike;

- ✓ Inkurajimi i grave të përfshihen në mënyrë aktive në jetën politike dhe ngritjen e kapaciteteve të tyre, përmes trajnimit dhe mentorimit në bashkëpunim me organizata dhe partitë;
- ✓ Promovimi dhe rritja e dukshmërisë së grave në politikë, veçanërisht duke i emëruar ato si mbajtëse të listave të kandidatëve, si dhe promovimi i storjeve të suksesit të grave në politikë;
- ✓ Vendosja e masave për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi dhe format e ndryshme të dhunës përmes kodit të sjelljes së partisë dhe aktiviteteve parandaluese brenda partisë, me qëllim sigurimin e një mjedisi të sigurt për gratë në parti dhe politikë;
- ✓ Zbatimi i teknikave pozitive të fushatës dhe përdorimi i fjalimeve politike të ndjeshme ndaj gjinisë;
- ✓ Pjesëmarrje më e madhe e anëtarëve meshkuj të partisë në promovimin dhe mbështetjen e barazisë gjinore në parti dhe politikë në përgjithësi;
- ✓ Një pjesë e partive njihon nevojën për një ekuilibër midis jetës profesionale dhe private dhe presionit që është shumë më i madh për gratë në politikë.

Udhëzime të përgjithshme për partitë politike për pjesëmarrje më të madhe të grave në politikë



- ✓ Vlerësimi i jashtëm dhe/ose i brendshëm i dokumenteve, procedurave të partisë, si dhe kulturës brenda partisë nga perspektiva gjinore dhe identifikimi i elementeve dhe praktikave diskriminuese, si dhe vlerësimi i nevojave të grave anëtare të partisë;
- ✓ Institucionalizimi i parimit të barazisë gjinore në partitë politike që nënkupton rishikimin e dokumenteve të brendshme, përfshirë Statutin e partisë, procedurat dhe strukturën e partisë në të gjitha nivelet;
- ✓ Promovimi i demokracisë më të madhe brenda partisë, me gratë që marrin role më thelbësore në vetë partitë politike, përmes vendosjes së kuotave gjinore dhe/ose rritjes së tyre në 50%, në të gjitha organet e partisë;
- ✓ Vendosja e kuotave gjinore prej 50% për gratë kandidatë në zgjedhje, përfshirë në nivel lokal, përkatësisht kur nuk sigurohen kuota ligjore gjinore dhe shmangia e përdorimit të kandidatëve femra vetëm për plotësimin e vendeve të kandidatëve, për të cilat vlerësohet se do të kenë vota të pamjaftueshme;
- ✓ Zhvillimi i strategjive të partive dhe planeve të veprimit për barazinë gjinore me qëllime të qarta, aktivitete, afate kohore dhe burime të përshtatshme financiare për zbatimin e tyre, si dhe kryerja e monitorimit dhe vlerësimit të detyrueshëm për zbatimin e tyre në praktikë;
- ✓ Mbajtja dhe ripërtëritja e rregullt e të dhënave të ndara gjinore në parti, me qëllim monitorimin e tendencave, identifikimin e boshllëqeve të vjetra dhe të reja gjinore dhe vlerësimin e efekteve nga zbatimi i masave të caktuara gjinore;
- ✓ Vendosja dhe/ose forcimi i rolit të forumeve të grave brenda partive, përmes formalizimit të tyre, pavarësi financiare dhe sigurim i pjesëmarrjes aktive të tyre në proceset e vendimmarrjes në nivel të të gjithë partisë;
- ✓ Vendosja e masave për shpërndarjen transparente dhe të barabartë të burimeve brenda partisë, në veçanti për qasjen në burime të nevojshme për të kryer fushata të suksesshme zgjedhore;
- ✓ Sigurimi i dukshmërisë adekuate të grave gjatë fushatave zgjedhore, prania në media, shkëmbimi i ekspertizës, materiale partiake, etj., si dhe mbështetja dhe promovimi i modeleve të rolit të grave brenda partisë;
- ✓ Përdorimi i retorikës së ndjeshme gjinore në nivel partie, e cila nuk bazohet në stereotipet gjinore dhe që mbështet dhe promovon pjesëmarrjen e grave në jetën politike;
- ✓ Zhvillimi i mekanizmave të brendshëm për mbrojtjen e grave dhe promovimi i narратiveve për të nxitur qëndrime pozitive për gratë në politikë;
- ✓ Organizimi dhe zbatimi i trajnimeve të specializuara dhe programeve të mentorimit për gratë për zhvillimin e kapaciteteve, për përgatitjen e kandidatëve, për mbledhjen e fondeve, për paraqitje publike, për drejtimin e një fushate, etj.
- ✓ Vendosja e bashkëpunimit të partneritetit me organizatat, në ngritjen e kapaciteteve për promovimin dhe zbatimin e parimit të barazisë gjinore në kuadër të punës së tyre;
- ✓ Sigurimi i një mjedisi të sigurt për gratë anëtare të partive, nëpërmjet përcaktimit të ndalimeve të qarta për zbatimin e çdo forme të diskriminimit dhe dhunës me bazë gjinore dhe gjuhës së urrejtjes me bazë gjinore dhe sanksionimit të duhur, si dhe me thirrje publike për përmbytje nga çdo formë e dhunës me bazë gjinore dhe gjuhës së urrejtjes;
- ✓ Vendosje e masave për balancim më të mirë ndërmjet jetës private dhe profesionale, përmes së cilës nuk do të rrezikohet pjesëmarrja e grave në proceset partiake dhe politike. Në këtë drejtim, mund të parashikohen masa si mundësi për pjesëmarrje dhe votimi në mënyrë elektronike ose përmes një ndërmjetësi, ofrimi i ambienteve dhe persona për kujdesin ndaj fëmijëve, përshtatja e ngjarjeve me nevojat e grave, obligime pune fleksibël, etj.
- ✓ Propozimi i ndryshimeve dhe miratimi i legjislatonit që synon nxitjen e pjesëmarrjes së grave në politikë dhe kushtëzim gjinor për financim publik të partive politike, si Kodi zgjedhor, Ligji për barazi gjinore, Ligji për financimin e partive politike, etj.

Ky produkt është punuar në kuadër të projektit të zbatuar nga Fondacioni Westminsterit për Demokraci, i financuar nga Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar, me mbështetjen e Ambasadës Britanike në Shkup. Mendimet dhe qëndrimet e shprehura në këtë përmbytje nuk pasqyrojnë çdo herë mendimet dhe qëndrimet e Qeverisë Britanike.

Gjetjet kryesore të diskutimit



Praktikë pozitive nga Mbretëria e Bashkuar

- ✓ Si rezultat i avokimit nga lëvizja feministe për përfaqësim të barabartë të grave në politikë, dhe vendosjes së kuotave gjinore dhe listave të hapura, në zgjedhjet e vitit 1997 numri i grave në Parlamentin e Mbretërisë së Bashkuar arriti numër dyfish më të lartë;
- ✓ Një masë e rëndësishme e aplikuar është ofrimi i trajnimeve për gratë për përfshirje dhe pjesëmarrje më të madhe në politikë. Njëra nga partitë, për shembull, ofron trajnime në të gjithë vendin, të realizuara nga ekspertë dhe ish-deputetë për të udhëhequr gratë përmes procesit të fushatës, forcimin e aftësive të nevojshme, logjistikë, etj., si dhe një program lidhës për gratë anëtare, i cili synon të inkurajojë dhe trajtojë gratë për role udhëheqëse;
- ✓ Gratë më shpesh i nënshtrohen shqetësimeve në mediat sociale, për dallim nga burrat, shqetësimi i grave, i cili është kryesisht i natyrës seksuale, paraqet një nga pengesat për përfshirjen e grave në politikë. Prandaj, është e nevojshme të sigurohen kushte në të cilat gratë nuk do të ndjehen të kërcënuara për bu angazhuar në politikë. Kështu, për shembull, një parti në Mbretërinë e Bashkuar ka një procedurë zyrtare për mbrojtje nga ngacmimi seksual, duke përkrahur qartë hapat dhe kontaktet për raportimin konfidencial dhe mbrojtje nga ngacmimi seksual;
- ✓ Nëse një grua ka një fëmijë për të cilin duhet të kujdeset dhe nuk mund të vijë në parlament për të votuar, në Mbretërinë e Bashkuar ekziston një sistem votimi përmes një ndërmjetësi, përkatësisht, një nga kolegët/et e saj mund të votojë në emër të saj.
- ✓ Prania në rritje e grave në politikë po rezultojnë të jetë veçanërisht e rëndësishme në rritjen e ndërgjegjësimit për tema të caktuara dhe miratimin e ligjeve që janë relevante për gratë

Financimi i partive politike për rritjen e barazisë gjinore

- ✓ Mbështetja financiare është një nga parakushtet që gratë të mund të angazhohen në fushata të ndryshme politike, të jenë aktive dhe të suksesshme. Rolet tradicionale gjinore dhe pritjet shoqërore mund të pengojnë ndjeshëm qasjen e grave në burimet financiare në politikë, ndërsa në disa vende vetë legjislati nuk mbështet financimin e pjesëmarrjes politike të grave;

- ✓ Vendosja e kuotave në shumë vende ka kontribuar në rritjen e pjesëmarrjes së grave, por ato nuk janë të mjaftueshme për të siguruar përfaqësim të vërtetë dhe dëgjim të zërit të tyre në politikë;
- ✓ Në shumë vende, financimi i fushatës mbështetet shumë në donacionet private, të cilat mund të favorizojnë kandidatët me pasuri të madhe personale ose qasje në rrjete të pasura politike, fusha ku gratë shpesh janë në disavantazh;
- ✓ Gratë fitojnë mesatarisht më pak se burrat, gjë që mund ta bëjë më të vështirë për të vetëfinancimin e fushatave ose kontributin në partitë politike;
- ✓ Partitë politike kanë më pak mundësi të mbështesin kandidatet femra financiarisht dhe organizativisht, shpesh për shkak të rreziqeve të perceptuara zgjedhore ose paragjykimëve në lidhje me aftësitë udhëheqëse të grave;
- ✓ Adresimi i këtyre sfidave kërkon një qasje të shumë-anshme, duke përfshirë reformimin e ligjeve për financim të fushatës në mënyrë që të barazohen kushtet e lojës, sigurimin e burimeve dhe ndryshimin e qëndrimeve shoqërore ndaj kandidatëve femra.

Roli i medias mbi dhunën ndaj grave në politikë

- ✓ Mediat përdorin dhe afirmojnë stereotipet gjinore duke përfshirë pjesëmarrjen e grave në politikë, duke kontribuar kështu në normalizimin e kulturës së dhunës me bazë gjinore,
- ✓ Narrativet antigjinore përfaqësohen gjerësisht në media, që rezultojnë në përhapjen e dezinformatave gjinore që synojnë dëmtimin e reputacionit të politikaneve, denigrimin e personalitetit dhe aftësive të tyre, etj., qëllimi përfundimtar i të cilave është përjashtimi i grave nga diskursi publik;
- ✓ Postimet e raporteve gazetareske në mediat sociale përdoren për të krijuar dhe përhapur dezinformata gjinore dhe janë terren pjellor për gjuhën e urrejtjes dhe ngacmimin me bazë gjinore.
- ✓ Është e nevojshme që mediat të krijojnë dhe plasojnë përmbajtje për të rritur ndërgjegjësimin për efektet negative të dhunës me bazë gjinore dhe të promovojnë parimin e barazisë gjinore.

